

Член 10

Започнатите постапки до денот на започнувањето на примената на овој закон ќе завршат согласно со законот по кој биле започнати.

Член 11

Одредбите од членовите 1, 2, 3, 4, 5, 6 и 8 од овој закон ќе започнат да се применуваат со започнувањето на примената на Законот за општата управна постапка согласно со членот 141 од Законот за општата управна постапка („Службен весник на Република Македонија“ број 124/15).

Член 12

Овој закон влегува во сила осмиот ден од денот на објавувањето во „Службен весник на Република Македонија“.

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT
PËR PUNËSIM DHE SIGURIM NË RAST TË
PAPUNËSISË

Neni 1

Në Ligjin për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 37/97, 25/2000, 101/2000, 50/2001, 25/2003, 37/2004, 4/2005, 50/2006, 29/2007, 102/2008, 161/2008, 50/10, 88/10, 51/11, 11/12, 80/12, 114/12, 39/14, 44/14, 113/14, 56/15, 129/15, 147/15 dhe 154/15), në nenin 27-a pas paragrafit 2 shtohen dy paragraf të rinj 3 dhe 4 si vijon:

“Personi zyrtar i autorizuar nga ministria kompetente për çështjet e punës i cili mban procedurën është i obliguar në afat prej tre ditëve nga dita e pranimit të kërkesës me detyrë zyrtare t’i sigurojë provat dhe të dhënat e nevojshme për dëshmimin e plotësimin të kushteve nga neni 27 paragrafi 1 alinetë 2 dhe 5 të këtij ligji.

Personi zyrtar i autorizuar nga organi kompetent publik nga i cili kërkohen provat dhe të dhënat nga paragrafi 3 të këtij neni është i obliguar të paraqesë provat dhe të dhënat në afat prej tre ditë nga dita e pranimit të kërkesës.”

Paragrafët 3, 4, 5 dhe 6 bëhen paragrafë 5, 6, 7 dhe 8.

Neni 2

Në nenin 47, në fjalinë hyrëse, pas fjalës “ligj” vendoset presje dhe shtohen fjalët: “Ligjin për procedurë të përgjithshme administrative”.

Neni 3

Në nenin 74 pas paragrafit 3 shtohen tre paragrafë të rinj 4, 5 dhe 6, si vijon:

“Personi zyrtar i autorizuar nga Agjencia i cili e mban procedurën është i obliguar në afat prej tre ditëve nga dita e pranimit të kërkesës me detyrë zyrtare t’i sigurojë provat dhe të dhënat e nevojshme për dëshmimin e plotësimin të kushteve nga neni 65 të këtij ligji.

Personi zyrtar i autorizuar nga organi kompetent publik nga i cili janë kërkuar provat dhe të dhënat nga paragrafi 4 të këtij neni është i obliguar të paraqesë provat dhe të dhënat e kërkuara në afat prej tre ditë nga dita e pranimit të kërkesës.

Formularin e kërkesës nga paragrafi 1 të këtij neni dhe dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e të drejtës për kompensim me para i përcakton ministri kompetent për çështjet nga sfera e punës, në pajtim me ministrin për Shoqëri Informatike dhe Administratë.”

Neni 4

Në nenin 80 në paragrafin 2 fjala “me shkrim”, shlyhet.

Neni 5

Neni 81 ndryshon si vijon:

“Lidhur me kërkesën për realizimin e të drejtave nga neni 80 paragrafi 1 i këtij ligji Agjencia ku është evidentuar personi i papunësuar, miraton aktvendim në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës.

Ankesa kundër aktvendimit nga paragrafi 1 të këtij neni paraqitet te ministria kompetente për çështjet nga sfera e punës në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit dhe nuk e prolongon ekzekutimin e aktvendimit.”

Neni 6

Nenet 81-a dhe 81-b, shlyhen.

Neni 7

Në nenin 91 paragrafi 4 pika 5) në alinenë 5 fjala “ose”, shlyhet.

Alineja 6 shlyhet.

Neni 8

Në nenin 100 pas paragrafit 3 shtohen dy paragrafë të rinj 4 dhe 5 si vijon:

“Gjobë në shumë prej 25 deri 50 deri në euro në kundërvlerë të denarit do t’i shqiptohet për kundërvajtje personit zyrtar të autorizuar i cili udhëheq me procedurën, nëse:

- nuk i siguron provat në afat prej tre ditë nga dita e pranimit të kërkesës (neni 27-a paragrafi 3 dhe neni 74 paragrafi 4) dhe

- nuk vendos për kërkesën në afat prej 30 ditë nga dita e pranimit të kërkesës (neni 80 paragrafi 3).

Gjobë në shumë prej 25 deri në 50 euro në kundërvlerë të denarit do t’i shqiptohet për kundërvajtje personit të autorizuar të organit publik kompetent nga i cili janë kërkuar provat dhe të dhënat, nëse nuk i paraqet provat dhe të dhënat e kërkuara në afat prej tre ditë nga dita e pranimit të kërkesës (neni 27-a paragrafi 4 dhe neni 74 paragrafi 5).”

Paragrafi 4 bëhet paragraf 6.

Neni 9

Akti nënligjor i përcaktuar me këtë ligj do të miratohet në afat prej 30 ditë nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 10

Procedurat e filluara deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji do të përfundojnë në pajtim me ligjin me të cilin kanë filluar.

Neni 11

Dispozitat e neneve 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 8 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen me fillimin e zbatimit të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative në pajtim me nenin 141 të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 124/15).

Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.